



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE



UDHËZUES PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E
UDHËZUESIT PËR LIBERALIZIMIN E TREGUT TË ENERGISË
ELEKTRIKE NË KOSOVË

Prishtinë, 13 qershor 2018



Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji sipas autoritetit të dhënë me Nenin 9 paragrafin 1, nën paragrafin 1.7, Nenin 25, Neni 26, të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05-L-084), në seancën e mbajtur me datë 13 qershor 2018 miratoi:

UDHËZUESIN PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E UDHËZUESIT PËR LIBERALIZIMIN E TREGUT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NË KOSOVË

Neni 1 Qëllimi

Qëllimi i këtij Udhëzuesi është ndryshimi dhe plotësimi i Udhëzuesit për Liberalizimin e Tregut të Energjisë Elektrike në Kosovë të nxjerr me datë 18 janar 2017, nga Bordi i Rregullatorit.

Neni 2

Neni 8 paragrafi 1 nënparagrafi 1.3 ndryshohet dhe plotësohet me tekstin në vijim:

- 1.3. “Konsumatorët komercial në nivelet e tension 35kV, 10kV do t’i nënshtrohen kushteve dhe çmimeve të tregut për furnizim me energji elektrike më së largu deri më 31 mars 2019”.

Neni 3 Dispozitat kalimtare

Dispozitat tjera të Udhëzuesit për Liberalizimin e Tregut të Energjisë Elektrike të nxjerr me datë 17 janar 2017 nga Bordi i Rregullatorit, mbeten të pandryshuara dhe do të zbatohen në tërësi.

Neni 4

Rregullatori do të ndërmarr veprime konkrete ligjore për plotësimin e kushteve teknike dhe ligjore që ndërlidhet me çështjet e përshkruara në udhëzuesin për liberalizimin e tregut.

Neni 5 Ndryshimi

1. Rregullatori ka të drejtën që të ndryshoj ose modifikoj dispozitat e këtij Udhëzuesi.
2. Procedurat për ndryshim ose modifikim të këtij Udhëzuesi do të jenë të njëjta si për miratimin e tij.



Neni 6 Interpretimi

Në rast se ka paqartësi për dispozitat e këtij Udhëzuesi, Bordi do të nxjerr informacione shpjeguese.

Neni 7 Hyrja në fuqi

Ky Udhëzues hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i Rregullatorit dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Bordi i Rregullatorit:

Arsim Janova, u.d. Kryesues

Besim Sejfiqaj, anëtar

Selman Hoti, anëtar

Izet Rushiti, anëtar